


Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. 81/23

Datë: 28.08.2023

Në bazë të nenit 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27, 34, 35, 39 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe nenet 18 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë: 11.07.2023, me Nr. Prot. 314/23-01/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët nga ALFI RE dhe CBE INVEST mbi ndërmarrjen QUADRO, me përfaqësues ligjor z. Korab Rexhepi, Avokat.

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 28.08.2023, mori këtë vendim;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve ALFI RE, (Menaxhim i Fondeve Investimeve Alternative Sh.p.k) dhe CBE INVEST (menaxhim i pasurive të paluajtshme Sh.p.k.) lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi ndërmarrjen QUADRO (menaxhim i pasurive të paluajtshme Sh.p.k).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje më nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja tre mijë Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 11.07.2023, me Nr. Prot. 314/23-01/H ka pranuar kërkesën për njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët nga ALFI RE dhe CBE INVEST mbi ndërmarrjen QUADRO.

Palët në Përqendrim

ALFI RE, (upravljanje alternativnih investicijskih skladov, d.o.o.), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me adresë: Verovshkova ulica 55A, 1000 Ljubjana, me numër të regjistrimit të biznesit 8512906001.

CBE INVEST, (poslovanje z nepremičninami d.o.o.), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me adresë: Tehnoloshki park 20, 1000 Lubjanë, dhe numër të regjistrimit të biznesit 8159505000.

QUADRO, (poslovanje z nepremičninami d.o.o.), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në përputhje me ligjet e Republikës së Sllovenisë, me adresë: Tehnoloshki park 20, 1000 Lubjanë, dhe numër të regjistrimit të biznesit 9208216000.

Baza Ligjore

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i njërës palë në Përqendrim (tregun e brendshëm e kalon shumë 1,000,000 Euro.
- c) Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen për fitim të kontrollit të përbashkët të lidhur me datë 26 Qershor 2023.
- d) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 26.06.2023.
- e) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesi është ndërmarrje e lidhur dhe pjesë përbërse e kompanive ALFI SKLADI i cili është prezent përmes shitjeve në Republikën e Kosovës.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 28.07.2023
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 31.07.2023
4. Më datë 26.06.2023 ALFI RE dhe CBE INVEST kanë nënshkruar Marrëveshjen për blerjen/fitimin e kontrollit të përbashkët mbi QUADRO (targeti).

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar, ka të bëjë me fitimin e kontrollit të përbashkët mbi QUADRO (**Ndërtesën afariste Quadro**) e cila aktualisht nuk është përfunduar dhe e marrë përsipër, dhe pas realizimit do të jetë në pronësi të përbashkët ndërmjet ALFI RE dhe CBE INVEST, transaksioni do të realizohet në Republikën e Sllovenisë, dhe si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, pasi që pjesmarrësit në përqendrim nuk kanë degë të regjistruar në Kosovë, e gjithë qarkullimi i tyre bëhet përmes shitjeve, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, meqenëse shitblerja e pronës së paluajtshme do të bëhet jashtë Kosovës, dhe prona e paluajtshme e cila është target i këtij transaksioni nuk do të operojë në aktivitetin e saj në Kosovë, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregjet Relevante dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu relevant, përcaktimi i tregut relevant mund të lihet i hapur.

Tregu i Produktit, tregu i biznesit i pasurive të pa luajtshme

Tregu gjeografik, do të përcaktohet tregu kombëtar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Sllovenisë, kërkesa për Njoftim të Përqendrimit është bërë për arsye se ALFI RE e cila është në pronësi të ALFI SKLADI do të ushtrij kontrollin e përbashkët mbi Quadro realizon të hyra përmes shitjeve në Kosovë. Sipas vlerësimit të përqendrimit, transaksion nuk do të ketë efekte negative për Konkurrencën e rrjedhshme për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva